



Pranuar / Dostiguar Puneheno/Prodato Received/Delivety	02.02.2024	4	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	682/2024		1/2



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1548/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1548/2023, të datës 20.12.2023 të ankuesit Mehdi Pllashniku të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adrese

kundër Vendimit me numër 6731/02-KOM të datës 13.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.02.2024, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1548/2023 e datës 20.12.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Vendimi me numër 6731/03-KOM i datës 13.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- III. Ky vendim zëvendëson aktin administrativ të kërkuar nga pala, gjegjësisht pezullohet procedura disiplinore e inicuar ndaj ankuesit.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Ankuesi i punësuar sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 07.05.2015 në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit në ARBK", në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, mirëpo përmes Vendimit me numër prot:3745 të datës 19.05.2021 të nxjerr nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i njëjti është caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës-ARBK, kurse përmes Vendimit me shifër: Ref.Nr.01/09 të datës 24.02.2023 të nxjerrë nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është shfuqizuar Vendimi me numër prot:3745 i datës 19.05.2021, nga lë të kuptohet se ankuesi pas datës 24.02.2023 i ka ushtruar detyrat e punës në pozitën e emëruar sipas akt emërimit të datës 07.05.2015.

Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës me datë 21.07.2023 përmes shkresës me numër prot:543/02 i është drejtuar Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nën pretendimin se ankuesi në cilësinë e udhëheqësit/personit përgjegjës ka krijuar praktika të kundërligjshme e që për pasojë në dosjet e bizneseve të regjistruara në ARBK, respektivisht "K. K" sh.p.k dhe "A. M" sh.p.k me rastin e regjistrimi u janë pranuar dokumente të cilat kanë përmbajtje në kundërshtim me parimet e Kushtetutës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi, ashtu që në rubrikën qyteti/shteti i lindjes janë përdorur Pejë-Serbia, Gjakova-Serbia. Tutje në të njëjtën shkresë të inicimit të procedurës disiplinore specifikohet se sipas raportit të Komisionit të Brendshëm të MINT me numër protokoll:4427 të datës 21.07.2023 pas rivlerësimit të dosjeve në ARBK rezulton se edhe 48 biznese të tjera janë lejuar të regjistrohen apo të bëjnë ndryshim në ARBK me të njëjtat shkelje.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 18.08.2023 ka nxjerr Vendim me numër 4892/02 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë në dy (2) vite".

Ankuesi kundër këtij vendimi me datë 29.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyresh për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër 5843/2023 e plotësuar përmes shkresës së datës 12.09.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 26.10.2023 ka nxjerr Vendim Anr.1123/2023 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke anuluar Vendimin me numër 4892/02 të datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe duke e detyruar të njëjtin që të nxjerr akt administrativ për pezullimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 13.11.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 6731/02-KOM me të cilin ka lënë në fuqi Vendimin me numër 4892/02 të datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë në dy (2) vite".

Ankuesi kundër Vendimit me numër 6731/03-KOM të datës 13.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, të cilin e ka pranuar më datë 22.11.2023, më datë 20.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7576/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej KPMSHCK*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa, KPMSHCK ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 20.12.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Autorizimin; Vendimin me numër 6731/02-KOM të datës 13.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Vendimin A.nr.1123/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.12.2023; Përgjigjen në ankesë; Ndryshimi dhe Plotësimi i akt emërimit të ankuesit i datës 07.05.2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore e datës 21.07.2023; Vendimin me numër 4892/02 të datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Procesverbalin e datës 01.08.2023, 31.07.2023, 02.08.2023 të Komisionit Disiplinor; Aktvendimin KA.nr.315/23 të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative i datës 02.08.2023; Fletëparaqitje nga e datës 31.01.2014 dhe 03.12.2015; Vendim për pushim për ankuesin datë 16.06.2023; Vendimin me Nr. 309 i datës 14.06.2023; Vendimin me Nr. 311 i datës 15.06.2023; Vendimin me Nr. 333 i datës 21.06.2023; Vendimin me Nr.326 i datës 21.06.2023; Raportin e datës 21.07.2023 për ri-verifikim të dosjeve në Asgjësinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës; Lista e bizneseve e të evidentuara; Emailin e datës 25.07.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 25.05.2023-i dërguar nga për ; Emailin e datës 31.07.2023 nga për Emailin e datës 31.07.12023 nga për Emailin e datës 31.07.2023 nga për Emailin e datës 11.07.2023, 17.07.2023 nga ankuesi për dhe Emailin e datës 24.07.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 25.07.2023, 24.07.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 25.07.2023 nga ankuesi për . Emailin e datës 26.07.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 25.07.2023 nga për Emailin e datës 25.07.2023 nga për , Emailin e datës 21.07.2023 nga Emailin e datës 01.08.2023 nga F.L për dhe Emailin e datës 02.08.2023 nga ankuesi për dhe Raport final i Auditimit të Brendshëm shtator 2021; Emailin e datës 03.08.2023 nga ankuesi për dhe Dosja e lëndës Klan Kosova Sh.P.K me dokumentet e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është *e bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 6731/02-KOM të datës 13.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pretendon se ky vendim është nxjerr në kundërshtim me

frymën e ligjit dhe në kundërshtim të plotë me obligimet sipas Vendimit A.nr.1123/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, po ashtu rasti nuk është dashur të trajtohet nga Komisioni Disiplinor i themeluar sipas Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë ngase rasti ka qenë në procedurë e sipër.

Fillimisht Kolegji i Këshillit konstaton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë mbi bazën e shkeljeve ligjore ndërlidhur me regjistrimin e "K.K" sh.p.k dhe "A.M" sh.p.k në kundërshtim me parimet e kushtetuese dhe ligjore, mirëpo sipas provave të lëndës fillimisht përmes Vendimit nr.309/11 të datës 14.06.2023 të nxjerr nga Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës i është bërë pezullimi i Certifikatës së biznesit së kompanisë "K. K Sh.P.K NUI810795297" të datës 29.05.2023, kurse ky vendim është shfuqizuar përmes vendimit me Nr. 333 të datës 21.06.2023 të nxjerr nga organi i njëjtë, ndërsa përmes Vendimit me Nr.326 të datës 21.06.2023 është anuluar Vendimi me Nr.333 i datës 21.06.2023 dhe është lënë në fuqi Vendimi me Nr. 309 i datës 14.06.2023 dhe Vendimi me Nr. 311 i datës 15.06.2023. Kundër vendimit për pezullimin e certifikatës së biznesit, kompania në fjalë kishte parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve përmes Vendimit të datës 28.07.2023 i ka refuzuar ankesën palës ankuese, e cila ndaj të njëjtës ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 02.08.2023 ka nxjerr Aktvendim KA.nr.315 përmes të cilit ka aprovuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të datës 28.07.2023 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimin nr.309/11 të nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, derisa gjykata të vendos meritorisht me vendim përfundimtar përkitazi me padinë e palës paditëse.

Në aspektin e shqyrtimeve të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh rastin dhe gjendjen faktike të elaboruar sipas Vendimit A.nr.1123/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbetet në tersi pranë theksimeve si në vendimin e lartcekura, ndërsa në këtë çështjet juridike-administrative do të shqyrtoj ligjshmërinë e Vendimit me numër 6731/02-KOM të datës 13.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe obligimet që kanë rrjedh si rezultat i Vendimit A.nr.1123/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kështu që Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale konstaton se meqenëse sipas Vendimit A.nr.1123/2023 të datës 26.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është anuluar Vendimi me numër 4892/02 i datës 18.08.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ,duke e detyruar të njëjtin që të nxjerr akt administrativ për pezullimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, atëherë Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.6371/02-KOM, nuk ka zbatuar Vendimin Anr.1123/2023 të datës 26.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ngase ka lënë në fuqi një vendim i cili është anuluar me vendimin e lartcekur të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi këtë bazë ka ndërhyrë direkt në kompetencat e Këshillit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj", sepse nuk mund të

lihet në fuqi një vendim i cili është anuluar nga një organ i shkallës më të lartë respektivisht nga Këshilli, ngase vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është vendim i formës së prerë, ndërsa kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ siç parashihet me nenin 22 të këtij ligji, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nuk ka asnjë mandat ligjor të mos zbatoj vendimet e një organi më të lartë administrativ të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i nxjerrë sipas procedurave të parapara ligjore, përderisa nuk është kontestuar ky vendim në rrugë gjyqësore me që rast do të mund të shtyhej ekzekutimi i këtij vendimi nga instancat gjyqësore sepse ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit e vlerësojnë vetëm gjykatat.

Konstatimi i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 6731/02-KOM të datës 13.11.2023 me të cilin konstaton se nuk ka bazë për pezullimin e procedurës disiplinore, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky është një konstatim i pabazuar dhe i paqëndrueshëm ngase kjo e drejtë rrjedhë nga Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht neni 2 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1, i cili ka përcaktuar se: *“Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ”*, po ashtu duke marr parasysh faktin që rasti për arsyet e të cilit ankuesit i është inicuar procedurë disiplinore është në shqyrtim nga gjykata në trajtim meritore, atëherë Kolegji i Këshillit konstaton se sipas dispozitave të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”*, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka qenë i obliguar që të bëjë pezullimin i procedurës disiplinore ndaj ankuesit deri në vendimmarrjen nga gjykata kompetente lidhur me rastin, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe pas vendimit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me numër 6731/03-KOM i datës 13.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është në kundërshtim me nenin 99 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se përderisa ankuesi ndaj Vendimit me numër 4892/02 të datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka parashtruar ankesë në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe në kohën kur ka filluar së zbatuari Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, atëherë duke marr parasysh faktin që me Vendimin A.nr.1123/2023 të datës 26.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është detyruar Komisioni Disiplinor të shqyrtoj këtë rast, atëherë sipas nenit 99 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *“7. Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkas për përfundimin e mandatit të komisioneve të themeluara në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Në rast se këto komisione kanë në shqyrtim procedura të rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave, duhet të përfundojnë këto procedura, dhe më pas konsiderohet se përfundon mandati i tyre”*, kështu që rasti i ankuesit është dashur të shqyrtohet nga Komisioni paraprak Disiplinor.

Bazuar si më sipër Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër 6731/03-KOM i datës 13.11.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe në kundërshtim me gjendjen faktike, dhe meqenëse i njëjtë është nxjerr si rezultat i shkeljeve të lartcekura, është akt administrativ i paligjshëm në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit ndaj këtij vendimi janë të bazuara.

Duke marr parasysh konstatimin e paligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë, dhe meqë pala ankuese në ankesën e datës 20.12.2023 kërkon që të anulohet Vendimi me numër 6731/03-KOM i datës 13.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, atëherë Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në kuptim të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"4. Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala"*, bënë pezullimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit deri në vendosjen përfundimtare të rastit nga gjykata kompetente, kështu që ky vendim e zëvendëson aktin administrativ e kërkuar nga pala.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

#### KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1548/2023, datë 02/02/2024

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.